



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016  
Nr. Dok. 201600851/4

**Lënda:** Rekomandohet "Fillimi i hetimit në ngarkim të shtetaseve A. Ll., R. C., etj punonjës në Qendrën Rezidenciale të Fëmijëve Shkollorë 6-18 vjeç, Shkodër, persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal".

**Drejtuar:** Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor  
Z. Granit SHAHU

**SHKODËR**

**Për dijani:** Prokurorit të Përgjithshëm  
Z. Adriatik LLALLA

**TIRANË**

*Të nderuar Zotërinj,*

Më datën 19.04.2016, në zbatim të urdhrit të Avokatit të Popullit nr.93, datë 11.04.2016, një grup Ndhimëskomisionerësh të Institucionit kanë kryer inspektim në Qendrën Rezidenciale të Fëmijëve Shkollorë 6-18 vjeç, Shkodër. Objekti i inspektimit ishin kushtet dhe trajtimi i fëmijëve në këtë institucion. Grupi inspektues realizoi këqyrjen e kushteve materiale në të cilat jetojnë fëmijët në ambientet e përbashkëta, dhomat e gjumit, kuzhina etj., si dhe administroi dokumentacionin e mbajtur në lidhje me aktivitetet që zhvillohen me fëmijët, kartelat mjekësore, dosjet psiko-sociale, shkollimin dhe edukimin e tyre. Po ashtu, nga ekspertët e Avokatit të Popullit janë zhvilluar intervista konfidenciale me fëmijët e grup moshave të ndryshme, lidhur me trajtimin e tyre nga stafi i këtij institucioni. Gjatë intervistave fëmijët shpjeguan raste të ushtrimit të dhunës nga edukatorët, apo praninë e fëmijëve të ish drejtoreshës Albana Llazani, aktualisht psikologe në këtë institucion, të cilët kanë ushtruar dhunë fizike ndaj fëmijëve, apo dhe ngacmime seksuale ndaj të miturave femra. Mbi këtë shqetësim, Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, veprim i cili është realizuar më datë 25.04.2016, me

shkuarjen në vend të një grupi ekspertësh të cilët kanë kryer veprime të ndryshme në kuadër të këtij hetimi si, marrjen e shpjegimeve të fëmijëve të dëmtuar nga vepra penale apo që kishin dijeni për të, apo dhe administrimin e dokumenteve të ndryshme që dispononte drejtoria apo mjekja e Institucionit. Avokati i Popullit si një institucion që mbron të drejtat dhe interesat e ligjshme të qytetarëve kur ato cenohen nga veprimet apo mosveprimet e parregullta të administratës publike, për rastin konkret ka patur parasysh legjislacionin shqiptar dhe aktet ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Kështu në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë thuhet: *“1.Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. 2. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë.3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojnë shëndetin, moralin ose të rrezikojnë jetën e zhvillimin e tij normal”.*

Të drejta të fëmijëve janë të garantuara dhe nga Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria shqiptare, si Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e fëmijës” datë 20 Nëntor 1989, duke kujtuar se *“në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë”.*

### **Veprimet e kryera** **Baza për fillimin e hetimit të procedimit penal**

Që në fillim, ju informojmë për faktin se hetimi i pavarur administrativ që konsistoi në marrjen e shpjegimeve të lira të fëmijëve, u realizua nga Ndhmëskomisionerët e Avokatit të Popullit, një prej të cilave në profesionin mjekësor psikiatër dhe me të pranishme psikologjen e Shkollës 9 vjeçare “Xheladin Fishta” në qytetin e Shkodrës, znj. Antoneta Peraj.

Pavarësisht kushteve normale të krijuara në një nga mjediset e Shtëpisë së Fëmijës së këtij qyteti, konstatoam hezitim dhe frikë tek fëmijët e mitur, kjo dhe për faktin se pas inspektimit të kryer nga Ndhmëskomisionerët e Avokatit të Popullit më datë 19 Prill 2016, ata ishin thirrur nga edukatorë dhe drejtor i institucionit duke iu bërë presion për shpjegimet e dhëna. Ky qëndrim u reflektua edhe gjatë marrjes së shpjegimeve të nxënëses Xh.N, në intervistimin e realizuar tek zyra e drejtorit të shkollës 9 vjeçare “Xheladin Fishta” në prani të psikologes znj. Antoneta Pero.

Në shpjegimet e tij të datës 25.04.2016, shtetasi i mitur me inicialet F.T, i datëlindjes 17.07.2000 deklaroi se *“...kam dijeni për dhunën fizike të ushtruar nga edukatorja Rafaela Canaj ndaj fëmijës S.G, i moshës 9 vjeç. Kjo ngjarje e ndodhur në Janar 2016, në kohën kur fëmija ishte bërë synet (cirkumcizio) dhe ishte akoma me plagë. S.G., erdhi dhe më takoi vetë në korridor dhe më tha se i ka rënë zyshtë Rafaela me shkop të karriges tek plaga (organi gjenital ku ishte kryer ndërhyrja kirurgjikale) dhe ishte gjakosur (kishte patur hemorragji). Ky veprim ishte bërë tek një nga dhomat e mësimi, në prani të fëmijëve të tjerë të mitur. Të nesërmen për këtë veprim i kam thënë drejtorit Gëzim Mahmutaj në zyrën e tij dhe ai më tha se e ka për të mirën e vet. Në fillim të vitit 2015, në kohën kur drejtor e Shtëpisë së Fëmijës ishte Albana Llazani, një ditë një fëmijë tjetër i kësaj shtëpie, Shela (Shahe Hasanpapa, aktualisht rezidente në Shtëpinë e Fëmijës Sarandë) është larguar nga shtëpia dhe kur erdhi të nesërmen më tha duke qarë se, djali i madh i drejtoreshës e*

*kishte rrahur. Veç sa sipër, kam vënë re se zyshat, (edukatorët) ju kërkojnë fëmijëve të vegjël 10-12 vjeç, për të pastruar korridoret dhe banjat, si djemve ashtu edhe vajzave. Gjithashtu kam për të thënë se psikologja sjell shpesh në Shtëpinë e Fëmijës djalin e saj 14 vjeçar që quhet Bekim, i cili sillet keq me fëmijët duke i goditur dhe me shpulla.*

*Kur jam kthyer nga Tirana, ku kam qenë për vizitë pranë familjes time, shoku im D.J. që është 13 vjeç më tha se gjatë një ekskursioni në Razëm kishte parë Bekimin, djalin e Albanës që ngacmonte (të miturën) Xh.K, 12-13 vjeç”.*

Shtetasi D.J, i datëlindjes 27.10.2002, në shpjegimet e tij të datës 25.04.2016, deklaroi ndërmjet të tjerave se: “ *Kam dijeni se para dy vjetëve, mund të ketë qenë muaj vere, kur një ditë F.T., që është shoku im më tregoi një video në celularin e tij ku zysh Rafaela godiste A.Q-në 13 vjeç tek klasa e mësimit, me shkop në trup dhe ai qante e bërtiste. Sipas D.J, F.T-së i kishte humbur aparati i telefonit.*

*Mund të ketë qenë aty nga muaji Janar 2016, kur një ditë ka ardhur S.G, i cili i tha F.T, se Rafaela e kishte qëlluar tek plaga (organi gjenital ku ishte kryer ndërhyrja kirurgjikale), pasi ishte bërë synet dhe i kishte dalë gjak nga plaga, të cilin e pashë dhe vetë se po i rridhte gjak nëpër këmbë.*

*Në Shtëpinë e Fëmijës kam parë se zysh Albana sjell dy fëmijët e saj dhe djali më i vogël Bekimi ka ardhur në Velipojë dhe Razëm kur kemi shkuar ekskursion. Në Razëm kemi shkuar më 1 Qershor 2015, kur kam parë Bekimin që ngacmonte Xh. K, 12 vjeç, duke qenë të zhveshur nga mesi e poshtë, të dy. Kjo ka ndodhur tek një shtëpi e vjetër dhe unë i pashë pasi i ndoqa nga prapa”.*

Në shpjegimet e datës 25.04.2016, shtetasi i mitur A.Q, datëlindjes 19.03.2002, ndërmjet të tjerave deklaroi se: “*..kur ishte 8-9 vjeç ishte i sëmurë dhe nuk bënte detyrat dhe zyshë Rafaela e nxori nga klasa. Mandej e thirri tek një klasë tjetër (quhet kompani).Kishte të fshehur prapa një shkop, më kapi për dore dhe më çoi tek dushet, e mbylli derën dhe më gjuajti me shkop. Pasi më ra me shkop në trup, më mori me të mirë dhe më tha hajde mos qaj”.*

Gjatë hetimit administrativ, më datë 28 Prill 2016, i janë marrë deklarime dhe shtetases Fiqirete Gurzaku, nëna e shtetasit të mitur S.T, e cila sqaron se në periudhën e muajit Janar apo Shkurt 2016, me një mjek privat ka operuar djalin e saj S.G, në organin gjenital dhe për këtë e ka mbajtur në shtëpinë e saj në Tiranë për disa ditë. Sipas saj, djali S.G, ishte ankuar që kishte patur dhimbje në organin gjenital dhe kishte kërkuar ndihmë tek edukatorët, por ato nuk e kishin ndihmuar duke i thënë që ta lagte me ujë të ftohtë organin gjenital. Po ashtu, djali S.G, ishte ankuar tek nëna e tij Fiqirete Gurzaku se rrihej shpesh prej njëri nga fëmijët më të rritur në Shtëpinë e Fëmijës.

### **Mendime dhe përfundime**

Shërbimet Sociale për fëmijët kanë për qëllim mbrojtjen dhe sistemimin në Institucione të Përkujdesit Shoqëror të fëmijëve në nevojë, si fëmijët jetimë socialë dhe biologjikë deri në moshën 18 vjeç, çka do të thotë se këta fëmijë janë të privuar nga kujdesi prindëror, dhe për rrjedhojë është shteti ai që ka marrë dorëzaninë e tyre.

Është detyra e Qendrave Rezidenciale për fëmijët e rritur jashtë familjes të gjejnë një mjedis të sigurt, përkujdes cilësor, që ju mundëson atyre duke lënë

institucionin ose të gjejnë rrugën në shoqëri, si qytetarë të përgjegjshëm dhe plotësisht të integruar në jetën e komunitetit, ose mund të kthehen në familjet e tyre biologjike, ose në familje që do të mundësojnë rritjen e tyre.

Nga hetimi administrativ i kryer rezultoi se nga punonjësit e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor 6-18 vjeç Shkodër, janë kryer veprime të kundërligjshme në cenim të interesave të ligjshëm të shtetasve, fëmijëve të mitur të atij institucioni

Nga analiza e veprimeve të kryera konstatohet se:

*Së pari:* Nga ish drejtorja e Shtëpisë së Fëmijës Albana Llazani, janë lejuar në atë Institucion, apo dhe marrë gjatë ekskursioneve të organizuara në Velipojë dhe Razëm dy fëmijët, të cilët duke qenë jashtë kontrollit të saj, kanë ushtruar dhunë fizike ndaj fëmijëve dhe në raste të tjera djali B.LI ka ngacmuar seksualisht fëmijët e seksit femër me moshë më të vogël se ai.

*Së dyti:* Nga edukatorët e Shtëpisë së Fëmijës në mënyrë flagrante janë lejuar fëmijët e mitur me moshë 10-12 vjeç të lajnë korridoret dhe banjat e Institucionet, veprim ky që bie ndesh dhe me pikë 3 të nenit 54 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

*Së treti:* Nga edukatorët Rafaela Canaj etj, është ushtruar dhunë fizike duke i rrahur me shkop druri të këmbëve të karrigeve, ndaj fëmijëve të mitur si S. A., etj.

*Së katërti:* Në Shtëpinë e Fëmijës Shkodër, personeli manifeston sjellje e qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve të komuniteteve rome apo egjiptiane, veprim ky i konfirmuar nga deklaratimet e të miturit F.T.

Nga analiza në tërësi e rastit, rezulton se punonjësit e Shtëpisë së Fëmijës Shkodër ish drejtorja e komanduar Albana Llazani, sot psikologe, Rafaela Canaj me detyrë edukatore etj, në kryerjen e funksioneve publike në sajë të detyrës shtetërore, me mosveprimet dhe veprimet e tyre të kundërligjshme, të cilat përbëjnë mos përbushje të rregullt të detyrës kanë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetasve, fëmijëve të mitur të atij institucioni. Ka një lidhje shkakësorë të drejtpërdrejtë midis veprimit dhe mosveprimit të kundërligjshëm, mos përbushje të rregullt të detyrës dhe dëmtimit të interesave të ligjshëm të shtetasve, me pasoja në dëm të shëndetit të tyre apo atij moral në rastet e ngacmimeve seksuale.

Me qëllim kryerjen e një hetimi të gjithanshëm do të sugjeronim që organi i Prokurorisë të kryejë dhe disa veprime hetimore të nevojshme si:

1. Kryerjen e një ekzaminimi dhe ekspertimi gjinekologjik për fëmijët e mitur femra të ngacmuara seksualisht nga personi i dyshuar shtetasi B. LI, si XH.K. etj, me qëllim kryerjen e hetimit dhe për vepra të tjera penale me objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur zhvillimin normal seksual e formimin moral të të miturve, që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç, apo kur nuk kanë arritur pjekurinë seksuale.
2. Shtrirjen e hetimeve duke marrë deklaratime dhe personave të tjerë që mund të kenë dijeni për rastet, dhe si të tillë mund të jenë nxënës që janë në një klasë më fëmijët e dëmtuar, psikologë të shkollës ku ata mësojnë etj.
3. Marrjen e deklaratimeve të shtetasës Shahe Hasanpapa, si person që ka dijeni për rrethana të dobishme për hetimin.

#### 4. Mendojmë se hetimi duhet të përfshijë periudhën kohore 2014-2016

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21 gërma “ç” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: “Avokati i Popullit, pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një veprë penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”,

### **REKOMANDOJMË**

*“Fillimin e hetimit në ngarkim të shtetaseve Albana Llazani, Rafaela Canaj etj, punonjës në Qendrën Rezidenciale të Fëmijëve Shkollorë 6-18 vjeç Shkodër, persona të dyshuara për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.*

Mbi qëndrimin që do të mbani ndaj rekomandimit, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni brenda afatit 30 ditor.

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

1. Memo, drejtuar Avokatit të Popullit z. Igli Totozani, datë 21.04.2016.
2. Proces verbalet e datës 25.04.2016, për marrjen e shpjegime të ankuesve të mitur F.T, S.G, A.Ç dhe D.J,
3. Proces verbal i datës 28 Prill 2016, për marrjen e shpjegimeve të shtetases Fiqirete Gurrzaku,
4. Kopje nga kartela mjekësore personale e shtetasit të mitur S.G.
5. Lista emërore e fëmijëve që ndodhen në Shtëpinë e Fëmijës Shkodër.
6. Lista e personave me gjeneralitetet e plota, si fëmijët ashtu dhe punonjësit e Shtëpisë së Fëmijës Shkodër.
7. Plane pune dhe aktivitetesh për vitin 2015 dhe 2016.  
Dokumente, gjithsej 55-pesëdhjetë e pesë- fletë

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**